



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 18 regjistër (JR)
Datë 09.04.2019

Nr. 13 i vendimit
Datë 08.07.2020

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Sokol Çomo	Kryesues
Luan Daci	Relator
Albana Shtylla	Gjyqtare
Ina Rama	Gjyqtare
Natasha Mulaj	Gjyqtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 08.07.2020, ditën e mërkurë, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Branko Hrvatin, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 106, datë 13.02.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni F, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Luan Daci, shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Golloshi, në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit ushtronte detyrën e ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit (në vijim “GjAA”) Tiranë, dhe i është nënshtuar procesit të rivlerësimit në bazë të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, i cili parashikon se të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*.
2. Në vijim të dorëzimit nga subjekti i rivlerësimit të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit (*vetting*) pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), rezulton se ky i fundit, bazuar në nenin 31 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka përgatitur raportin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Golloshi, ka arritur në përfundimet se:
 - a) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
 - b) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - ç) ka kryer deklaram të rremë; dhe
 - d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.
3. Në vijim të dorëzimit nga subjekti i rivlerësimit të deklaratës për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), rezulton se kjo e fundit pasi ka përgatitur raportin mbi kontrollin e figurës, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Golloshi.
4. Në vijim të dorëzimit nga subjekti i rivlerësimit të formularit të vetëvlerësimit profesional pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), rezulton se kjo e fundit a kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, znj. Ana Golloshi.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, me vendimin nr. 106, datë 13.02.2019, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Golloshi, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”, referuar nenit 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe nenit 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, pasi arriti në konkluzionet përfundimtare se:
 - a) subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, duke përfshirë dhe personat e lidhur;
 - b) subjekti i rivlerësimit kishte bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi kishte bërë deklaram të pasaktë dhe jo në

përputhje me ligjin, dhe kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive në emrin e saj dhe personit të lidhur me të.

5.1. Sipas analizës përmbledhëse, Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, analizoji treguesit financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet, për periudhën prej vitit 1996 - 27.01.2017, arriti në përfundimin se të ardhurat neto rezultojnë në shumën 14.180.311 lekë¹, pasuritë neto në shumën 32.950.240 lekë dhe, si pasojë, raporti pasuri neto/të ardhura neto, rezultonte në vlerën “2,32”.

5.2. Për periudhën 1996 - 31.12.2008, Komisionit i rezultoi balanca negative e fondeve me vlerë 7.787.025 lekë, duke çmuar si përfundim se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor, qoftë dhe me indice indirekte, se të ardhurat e përfituara nga emigracioni janë më të larta nga ato të evidentuara me dokumentacion justifikues ligjor.

5.3. Gjithashtu, për periudhën 01.01.2009 - 27.01.2017, Komisionit i rezultoi balancë negative me vlerë 10.982.905 lekë, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara, likuiditete, gjendje në llogari bankare dhe ato gjendje *cash*, nga ku Komisioni ka konstatuar se disa pasuri ishin evidentuar për herë të parë duke u depozituar në llogari bankare, gjatë kohës që subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, kishte qenë në funksionin e ndihmëses ligjore pranë GjAA Tiranë.

6. Në lidhje me kontrollin e figurës, pas hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetonin ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, dhe se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, Komisionit i rezultuan të sakta dhe të vërteta, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit kishte arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
7. Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni, pas propozimit të relatorit të çështjes, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, kishte arritur nivelin minimal kualifikues, referuar nenit 59, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

8. Kundër vendimit nr. 106, datë 13.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, paraqiti ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, e cila kërkoi: “Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 106, datë 13.02.2019. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”.

8.1. Nëpërmjet ankimit të paraqitur, subjekti i rivlerësimit parashtroi para Kolegjit shkaqe që lidhen me pretendime për shkelje procedurale, për konstatim të gabuar të gjendjes faktike, por edhe për zbatim të gabuar të ligjit material, duke theksuar se Komisioni duhet të mbante në konsideratë faktin se objekt i vlerësimit të pasurisë nuk është të analizohen thjesht shifra, por të gjykohen jeta, përpjekjet dhe sakrificat e subjektit të rivlerësimit, si dhe të një rrethi të gjerë

¹ Të ardhura të dokumentuara, 1996 - 27.01.2017, në shumën prej 32.994.015 lekësh, ndërsa shpenzime për periudhën 1996 - 01/2017, në shumën prej 18.813.704 lekësh.

personash të lidhur me të, duke mbajtur parasysh në radhë të parë specifikat në zhvillimet ekonomike dhe shoqërore të shtetit shqiptar ndër vite.

9. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, Komisioni ka cenuar parimin e proporcionalitetit, duke pretenduar se detyrimet e ndihmësve ligjorë për deklarimin e pasurisë dhe konfliktit të interesave nuk kanë qenë asnjëherë të njëjta me ato të subjekteve të tjera të rivlerësimit, pasi sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 dhe ligjit nr. 9367/2005, objekti i deklarimit të pasurive ka qenë të hetojë dhe ndëshkojë nëse një zyrtar është gjendur ose gjendet në konflikt ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë, detyrë në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthortë, që ndikojnë ose mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

9.1. Në referim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe të neneve 4, pika 5, 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe rekomandimit CM/Rec. (2010/12) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës², subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, pretendoi se pjesa më e madhe e të ardhurave të krijuara nga familja e saj ishin krijuar gjatë viteve të emigracionit, dhe se nga Komisioni duhej pasur parasysh fakti se remitancat³ kanë qenë e mbeten në nivele të larta, por shpeshherë të pashoqëruara me burimet legale të pagesës nga punëdhënësi e të pataksuara në Shqipëri.

10. Vlerësimi i raporteve pozitive të shërbimeve të inteligjencës⁴, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, si dhe i mjaftueshmërisë së përgatitjes profesionale, duhet të çonin Komisionin në konkluzionin se ajo nuk kishte bërë deklarim të pavërtetë, dhe kjo sipas saj tregon se trupi gjykues i Komisionit ka vepruar nën doza të larta paragjykimi dhe në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, çka ka ndikuar në humbjen e ekuilibrit përgjatë vlerësimit të subjektit dhe, si pasojë, vendimi i Komisionit rezulton sipas saj tërësisht alogjik.
11. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, pretendon se, në referim të neneve 33, 39 dhe 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, masa e shkarkimit mund të vendoset nëse plotësohen në mënyrë kumulative kushti i pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës, si dhe për kriterin pasurisë⁵. Jo çdo pasaktësi, vijon subjekti i rivlerësimit, duhet të përbëjë shkak shkarkimi, nëse këto pasaktësi nuk janë të lidhura me indicie për korrupsion apo veprimtari të tjera të paligjshme gjatë ushtrimit

² Rekomandimi CM/Rec. (2010/12) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtarë mbi gjyqtarët, miratuar më 17 nëntor 2010 parashikon se: "Procedurat disiplinore mund të pasojnë kur gjyqtarët nuk kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efikase dhe të duhur. Procedura të tilla duhet të kryhen nga një autoritet i pavarur ose një gjykatë me të gjitha garancitë për një gjykim të drejtë dhe t'i sigurojë gjykatësit të drejtën për të kundërshtuar vendimin dhe sanksionimin. Sanksionet disiplinore duhet të jenë proporcionale".

³ Referuar informacione të bëra publike nga Banka e Shqipërisë dhe IZA (Institute of Labor Economics).

⁴ Sipas subjektit të rivlerësimit, ajo nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo ndonjë shkak tjetër të konstatuar në përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës. Pra, edhe konkluzioni i trupit gjykues në lidhje me pasurinë e subjektit të deklarimit, nuk qëndron në raport me figurën, moralin dhe aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

⁵ Sipas subjektit të rivlerësimit, vetëm bashkekzistenca e papërshtatshme në lidhje me kriterin e pastërtisë së figurës dhe të pamjaftueshmërisë të pasurisë, në kuptim të ligjit, përbën shkak ligjor për marrjen e masës së shkarkimit nga detyra, dhe jo pa arsye ligjvënësi ka lidhur këto dy kritere në mënyrë të njëkohshme në nenin 61, pika 3, pasi pasaktësitë që mund të konstatohen në lidhje me kriterin e pasurisë duhet të jenë të lidhura me indicie për veprime të paligjshme gjatë ushtrimit të detyrës të cilat analizohen në kuadër të kriterit të vlerësimit të figurës, në mënyrë që të përligjin shkarkimin nga detyra të subjektit në referim të pikës 3 të nenit 61.

të detyrës, pasi në të kundërt, sipas saj, nëse do të kishte këtë qëllim, nuk do t'i kishte renditur ato si kritere kumulative në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, por si kritere alternative ose si shkaqe të pavarura që çojnë në shkarkim.

11.1. Mungesa e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, sipas shkronjës “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, sipas subjektit të rivlerësimit, mund të përbëjë deklaram të pamjaftueshëm në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të të njëjtit ligj, vetëm nëse është në atë nivel të rëndë shkeljeje, të krahasueshëm ose të barabartë me fshehje pasurie, deklaram të rremë apo situatë konflikti interesi, sipas shkronjave “c”, “ç” dhe “d” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Si pasojë, sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke cenuar qëllimin e ligjvënësit, i cili është të largojë nga sistemi i drejtësisë personat që janë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme dhe si pasojë e këtyre veprimtarive kanë krijuar pasuri, por jo që të largojë edhe personat që mund të kenë pasaktësi në deklaramet e tyre, pa pasur asnjë indicie minimale për përfshirjen në veprimtari të paligjshme apo të papajtueshme me detyrën e tyre.

12. Vendimi i Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 57, pikat 1 dhe pika 4, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, dhe me nenin 6 të KEDNj-së, pasi sipas saj nuk janë përcaktuar dispozitat ligjore se ku mbështetet ky vendim në nxjerrjen e përfundimeve, duke pretenduar se Komisioni kishte detyrimin që për çdo pikë të ngritur në vendim si shkak shkarkimi nga detyra, të shprehej dhe për dispozitën ligjore ku bazohej duke provuar dhe shkeljen konkrete të ligjit material dhe atij procedural.
13. Sipas subjektit të rivlerësimit, marrja, administrimi, hetimi kryesisht në lidhje me pasurinë, çmuarja e provave, dhe më pas dhënia e vendimit për këtë të fundit po nga i njëjti trup gjykues i Komisionit, cenon haptazi parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme⁶, dhe kjo pasi në veprimtarinë e saj i njëjti trup gjykues i Komisionit edhe heton faktet, edhe jep vendim në lidhje me gjetjet e bëra nga ajo vetë, dhe sipas saj, është edhe organ akuzator, edhe gjykatë.
14. Qëndrimi tendencioz, subjektiv dhe paragjykues i trupit gjykues të Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, shpaloet më së pari kur Komisioni ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar gatishmëri gjatë procesit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka vlerësuar se ajo ka dërguar deklaramet e saj dhe provat përkatëse jashtë afateve të përcaktuara, gjë që ka çuar në vonesën e procesit të rivlerësimit⁷.

14.1. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se në funksion të procesit të saj⁸, dokumentet thelbësore që vërtetonin burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave, ishin krijuar në shtetin grek dhe

⁶ Referuar vendimit të GjEDNj-së, Bellios kundër Zvicrës, datë 29.04.1988: “[...] një tribunal karakterizohet në kuptimin thelbësor të shprehjes nga funksioni i tij gjyqësor, me të cilin duhet kuptuar të vendosurit mbi çështjet brenda kompetencave të tij, bazuar në rregullimet ligjore dhe sipas procedurave të zhvilluara në mënyrë të caktuar. Ai duhet të kënaqë një numër kërkesash si pavarësia veçanërisht prej ekzekutivit, paansësia, qëndrueshmëria në detyrë e anëtarëve të tij, garancitë e ofruara nga procedura e tij prej të cilave shfaqen edhe në vetë tekstin e nenit 6/1 të KEDNj-së”.

⁷ Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, është kontradiktor dhe bie në kundërshtim me vetveten, pasi në seancë dëgjimore relatorja është shprehur se Komisioni konstaton se subjekti ka qenë përgjithësisht bashkëpunues gjatë këtij procesi.

⁸ I cili zgjati më pak se 5 muaj kalendarikë, në total 14.09.2018 - 13.02.2019, ndërkohë që për 3 prej kolegëve të saj të Shkollës së Magjistraturës procesi përfundoi për rreth 4 muaj e gjysmë, për 2 prej tyre përfundoi për 6 muaj, dhe për 3 prej tyre ende nuk ka përfunduar duke shkuar rreth 10 muaj, pra dyfishin e kohëzgjatjes së procesit të saj.

duheshin përkthyer nga gjuha greke, dhe për këtë arsye u dërguan pranë Zyrës së Përkthimeve në Ministrinë Greke të Punëve të Jashtme. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, shpjegon se nga ana e saj nuk është kuptuar drejt vendimi i qeverisë greke për heqjen e rezervës së vulës apostile, dhe pasi u njoftua nga Komisioni për shkresën nr. {***}, datë 09.10.2018, të Drejtorisë për Çështjet Konsullore së Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme (në vijim “MEPJ”), paraqiti pranë Komisionit pjesën më të madhe të dokumenteve⁹. Në vijim, subjekti i rivlerësimit parashtron se Komisioni nuk ka mbajtur parasysh faktin se ky dokumentacion ishte mjaft i hershëm, duke filluar nga viti 1996, pra i 22 viteve më parë, dhe faktin se as ajo e askush tjetër nuk kishin as tagrin dhe as forcën të detyronin organet kompetente të një shteti të huaj, për të konfirmuar dokumentet sipas afateve të caktuara nga Komisioni.

15. Në lidhje me dokumentet e dërguara elektronikisht në Komision në datën 16.01.2019¹⁰, subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, parashtron se nga dokumentacioni i marrë në formatin CD nga Komisioni në datën 29.01.2019, ka konstatuar se ky dokumentacion nuk ishte shkarkuar nga Komisioni dhe, për pasojë, Komisioni e ka vlerësuar të panevojshëm shqyrtimin dhe vlerësimin e këtij dokumentacioni, për sa kohë që edhe në rezultatet e hetimit as nuk ishte përmendur fare, përfundon subjekti i rivlerësimit¹¹.

15.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka argumentuar shkaqet përse është përjashtuar nga analiza dhe shqyrtimi i deklaratës *vetting* personi i dytë i lidhur, znj. N. S., nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që kjo e fundit është përfshirë në raportin e ILDKPKI-së. Gjithashtu, në lidhje me vendimin e trupit gjykues të Komisionit për mospranimin e znj. N. S., në cilësinë e dëshmitares, subjekti i rivlerësimit pretendon se i është mohuar e drejta e mbrojtjes, për më tepër që ky vendim i është dërguar vetëm një ditë para zhvillimit të seancës dëgjimore, duke mos i dhënë të drejtën asaj të ushtronte mbrojtjen në lidhje me shkaqet e refuzimit të kërkesës.

16. Duke iu referuar nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, neneve 49, pika 9 dhe 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, neneve 25 dhe 34 të ligjit nr. 49/2012, nenit 183 të KPrCivile, si dhe pikës 8 të “Hapave proceduralë të unifikuar për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, pretendon se rast pas rasti dhe provë pas prove, apo qoftë edhe në rastet kur Komisioni për lejimin e provave mund të vendoste në bllok, kishte detyrimin ligjor të bënte me dije palët për provat që pranonte të merrte në shqyrtim dhe provat që nuk pranonte të merrte në shqyrtim. Kjo mënyrë procedimi lidhur me

⁹ Përveç vërtetimit nga Zyra e Punës për asistencën e papunësisë dhe vërtetimit të {***} për shumën të depozituar pranë kësaj banke.

¹⁰ Që vërtetonte se personi i lidhur, z. Gj. S., ishte larguar nga territori i RSh-së me vulë dalje në datën 01.02.1994, dhe ishte kthyer përfundimisht në datën 13.10.2003; se personi i lidhur, znj. N. S., ishte larguar nga territori i RSh-së me vulë dalje në datën 17.07.1995, dhe ishte kthyer përfundimisht në datën 18.05.2005; se z. J. S. ishte larguar nga territori i RSh-së në datën 17.07.1995 së bashku me znj. N. S. dhe ishte kthyer përfundimisht në datën 08.01.2005, dhe se ajo vetë ishte larguar nga Shqipëria në datën 20.02.1997, dhe ishte kthyer në datën 08.01.2005.

¹¹ Subjekti i rivlerësimit shpjegon se, gjatë gjithë kohëqëndrimit në shtetin grek, z. J. S. dhe znj. N. S. kanë punuar pa u derdhur asnjëherë nga punëdhënësit e tyre kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, fakt për të cilin nuk mund të penalizohen, dhe se pa kontributin e tyre ekonomik nuk do të mund të siguronin ato të ardhura që kanë kursyer dhe sjellë në Shqipëri përgjatë gjithë periudhës së emigracionit, dhe bashkëshorti i saj ka punuar nga muaji korrik 1996 deri në muajin tetor 2003 pranë Spitalit {***}, {***}, Athinë, me dokumentacion të rregullt, gjithmonë në turnin e 3-të (pra natën), dhe gjithashtu, për shkak të profesionit të tij si mjek i përgjithshëm, ka punuar gjatë ditës për shërbime të ndryshme mjekësore në shtëpi të pacientëve, si: injeksione, mjekime plagësh, heqje penjsh, postoperatore, fizioterapi, punë kjo e ligjshme, por e padokumentuar.

provat, sipas subjektit të rivlerësimit, mban palët të informuara dhe të ndërgjegjshme mbi cilësinë e materialit provues të përdorshëm në veçanti dhe në përgjithësi mbi cilësinë e aktivitetit të mbrojtjes së tyre, dhe se vetëm në këtë mënyrë procesi gjyqësor plotëson standardët e procesit të ndershëm dhe të rregullt ligjor dhe njëkohësisht palëve u respektohet e drejta e mbrojtjes.

17. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, pretendon se duke qenë se metodologjia e përdorur nuk ishte veçse një rregullore e përgjithshme që nuk kishte asnjë vlerë për analizën financiare, atëherë për rrjedhojë iu mohua e drejta për t'u mbrojtur, për të paraqitur prova dhe për të dhënë shpjegime për të kundërtën, si dhe për të debatuar sipas parimit të kontradiktoritetit¹².
18. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, është treguar paragjykes dhe dukshëm i njëanshëm, pasi në mënyrë të qëllimshme jo vetëm nuk ka marrë parasysh që të ardhurat e krijuara nga ajo dhe personat e lidhur me të kanë qenë më të larta nga ato që rezultojnë të vërtetuara, por edhe të ardhurat që rezultojnë të vërtetuara me dokumentacionin përkatës se janë realizuar nga ana e tyre, është përpjekur t'i pakësojë në çdo mënyrë të mundshme¹³.

18.1. Ky qëndrim, sipas subjektit të rivlerësimit, evidentohet haptazi lidhur me analizën që i bën pjesës takuese 1/5 së shtëpisë së prindërve të saj të përfutur me privatizimin. Rast më flagrant, sipas subjektit të rivlerësimit, është kur të ardhurat nga kontrata e punës së bashkëshortit të saj si ekspert i jashtëm mjeko-ligjor pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore (në vijim “{***}”), Komisioni jo vetëm që nuk i ka marrë parasysh, por i konsideron si të ardhura nga subjekt tregtar¹⁴.

19. E gjithë procedura e kryer nga Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, ka qenë e paligjshme, pasi Komisioni konsideroi rezultat përfundimtar të hetimit relacionin e datës 22.01.2019, pa marrë aspak në shqyrtim provat e kundërta dhe shpjegimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit më datë 09.02.2019.

19.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk duhet të caktonte seancën dëgjimore pa kaluar afati i lënë subjektit për dorëzimin e provave. Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit duke mbajtur parasysh edhe dokumentacionin voluminoz që përmbante mbrojtja e saj, trupi gjyqësor i Komisionit e kishte të pamundur t'i studionte vetëm për një ditë, konkretisht ditën e hënë, më datë 11.02.2019, të gjitha provat. Nga ana tjetër, shpjegon subjekti i rivlerësimit, akti i

¹² Subjekti i rivlerësimit shpjegon se: “Në datën 29 janar 2019, pas konsultimit me dokumentacionin e mbledhur nga Komisioni në funksion të hetimit, kam konstatuar se në dosje mungonte metodologjia e llogaritjeve financiare të kryera nga ana e Komisionit. Për këtë arsye, i kam kërkuar Komisionit të më vendosë në dispozicion metodologjinë e përdorur përfshirë legjislacionin, vlerat e referencës, standardet dhe formulën e përdorur për arritjen e konkluzioneve financiare. Komisioni më vuri në dispozicion vetëm metodologjinë me një përshkrim në Word, por mungonte elementi kryesor, ai i formulës së përdorur. Kjo është bërë në mënyrë të qëllimshme, pasi nga kjo trupë gjyqësore është synuar në çdo moment si të hetimit, ashtu edhe në arsyetim të pakësojë në mënyrë të padrejtë dhe të qëllimshme të ardhurat e mia të ligjshme të vërtetuara”.

¹³ Çka e bën subjektin e rivlerësimit të dyshojë edhe për aftësitë profesionale të këshilltarit ekonomik, ashtu edhe të anëtarëve të trupit gjyqësor në interpretimin e dispozitave ligjore.

¹⁴ Pasi parashtron se, sipas kësaj logjike, ndaj të ardhurave të siguruara nga një kontratë pune me institucion shtetëror, duhet të aplikojmë edhe TVSH. Me kontratë pune, bashkëshorti im ushtron edhe detyrën e pedagogut të jashtëm pranë Universitetit të Mjekësisë. Me këtë logjikë, edhe këto të ardhura u dashka t'i përjashtojmë nga të ardhurat në bazë të një kontrate pune me institucion publik dhe t'i përfshijmë në të ardhurat e përfuturara si person fizik. Sipas subjektit të rivlerësimit, këto arsyetime tregojnë në rastin më të mirë paafësi profesionale dhe më tej edhe qëllime tendencioze të Komisionit për shkarkimin e saj.

ekspertimit financiar ishte mjaft i vështirë për t'u studiuar brenda një dite, pasi analizat ishin mjaft të vështira, dhe kjo vështirësi buronte më së pari prej faktit se edhe periudhat sipas analizës financiare të Komisionit, i detyronte që edhe të ardhurat e përfituara nga i njëjti destinacion t'i ndanim sipas periudhave të analizuara gjatë hetimit. Sipas subjektit të rivlerësimit, rezulton se edhe vetë këshilltari ekonomik ka kryer gabime në përlllogaritjen e tyre (konkretisht analiza është bërë duke u ndarë për periudhat 1996 - 2008 dhe 2009 - 2017).

19.2. Seanca e shpalljes së vendimit u caktua ditën e nesërme të seancës dëgjimore, pa u arritur sipas subjektit të rivlerësimit të shqyrtohej fare dokumentacioni i mbrojtjes, i cili të paktën për pjesën e pranuar nga Komisioni duhet të ishte pasqyruar që në relatin në seancë gjyqësore. Kjo, sipas saj, vërteton plotësisht se vendimi i shkarkimit ishte paracaktuar si i tillë, dhe seanca dëgjimore ishte një farsë, të cilën trupi gjykues i Komisionit ishte i detyruar ta zhvillonte vetëm se kështu e përcakton ligji.

20. Sipas subjektit të rivlerësimit, vlerësimi i Komisionit se ka karakter deklarativ dhe se është i pabazuar në prova pretendimi se ajo nuk kishte kontribut në krijimin e pasurisë në rr. “{***}”, Tiranë, me bashkëpronarë me pjesë 1/5 secili, znj. Ana Golloshi, z. N. G., znj. S. G., z. S. G. dhe znj. O. G., bie ndesh me nenin 253 e në vijim të KPrCivile, dhe se mospërfshirja në deklaratën *vetting* e togfjalëshit “të babait tim” apo “të prindërve të mi” nuk e bën automatikisht kontribuuese.

21. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Golloshi, kundërshton mospërfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga asistenca e papunësisë në Greqi, të ardhurat e ligjshme të përfituara nga paga e z. Gj. S. pranë {***}-së, si dhe të ardhurat e pensionit të pleqërisë së znj. N. S. dhe z. J. S..

21.1. Rezervat që ajo ka pasur për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit bankar në Shqipëri, ka bërë që jo të gjitha të ardhurat e tyre t'i depozitonte në bankat e nivelit të dytë, madje sipas subjektit të rivlerësimit, pavarësisht vlerës që kanë të depozituar në bankat e nivelit të dytë, asnjë prej tyre nuk e kalon vlerën 2.500.000 lekë, kufiri deri në të cilin sigurohen depozitat bankare sipas legjislacionit në fuqi.

21.2. Subjekti i rivlerësimit parashton se në kushtet kur deklarata *vetting* ka qenë deklarata e saj e parë e konfliktit të interesave, dhe se iu është dashur për një kohë mjaft të shkurtër të mblidhnin dhe të analizonin një dokumentacion voluminoz, nuk kanë mundur të kujtojnë një veprim të kryer vite më parë, i cili vërteton se babai i bashkëshortit të saj, z. J. S., dhe bashkëshorti i saj, z. Gj. S., kanë përfituar të ardhura nga një kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme të ndodhur në qytetin e Vlorës.

22. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, në shqyrtimin e çështjes, nuk është udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke cenuar rëndë garancitë e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 52 i ligjit nr. 84/2016, pasi sipas saj nga formulimi kushtetues i pikave 4 dhe 5 të nenit D, arrihet në konkluzionin se, kur subjekti i rivlerësimit deklaroi të ardhura që janë më shumë se pasuria e ligjshme, pa e kaluar dyfishin e saj, por arrin të provojë burimin e ligjshëm të krijimit, si dhe nuk përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, ai nuk prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore dhe nuk shkarkohet.

23. Bashkë me ankimin, subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Golloshi, ka paraqitur dokumentet e mëposhtme.

- Aktin e ekspertimit financiar, datë 28.03.2019, të audituesit G. B.¹⁵.
- Dokumentet e dala nga arkiva e ZVRPP Vlorë.
 - Vërtetimi nr. {***} rep., datë 19.05.1994, i Noterisë Vlorë¹⁶.
 - Vërtetimi i Noterisë Vlorë¹⁷.
 - Skica, datë 08.09.1992, e pasurisë në lagjen “{***}”, rr. “{***}”, pll. {***}, shk. {***}, ap. {***}.
 - Skica datë 08.09.1992 e pasurisë në lagjen “{***}”, rr. “{***}”, pll. {***}.
 - Certifikata familjare¹⁸.
 - Deklarata datë 22.09.1993, e znj. V. S.¹⁹.
 - Vërtetimi nr. {***} rep., datë 19.05.1994, i Noterisë Vlorë²⁰.
 - Kontrata për privatizimin e banesës, datë 22.09.1993, ndërmjet {***} dhe qiramarrëses znj. V. S..²¹
 - Mandatpagesa²².
 - Mandatarkëtimi nr. {***}.
 - Kartela e pasurisë së paluajtshme, pas. {***}, zk {***}, vol. {***}, f. {***}, rr. “{***}” ({***}), pll. {***}, sh. {***}, k. {***}, ap. {***}, Vlorë²³.
 - Inventari i brendshëm i dosjes.
 - Veprimi noterial i njësisë me origjinalin nr. {***}, datë 16.09.2008.
 - Mandati i arkëtimit nr. {***}, datë 03.10.2008.
 - Veprimi noterial i njësisë me origjinalin nr. {***}, datë 16.09.2008²⁴.
 - Vendimi nr. {***}, datë 09.07.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (në vijim “GjRrGjV”)²⁵.
 - Veprimi noterial i njësisë me origjinalin nr. {***}, datë 16.09.2008.
 - Vendimi nr. {***}, datë 18.07.2008, i GjRrGjV²⁶.
 - Inventari i brendshëm i dosjes.
 - Kërkesa, datë 05.01.2009, e znj. D. S., drejtuar ZVRPP Vlorë.

¹⁵ Sipas varianteve të audituesit financiar, raporti pasuri neto/të ardhura nuk rezulton në vlerë më të ulët se “1,74”.

¹⁶ Nga i cili rezulton se në datën 19.05.1994, para noterës Xh. L., u paraqitën personalisht, shitësi NK. B., dhe blerësi M. S., e cila deklaroi se ishte kontratë shitblerjeje e redaktuar jashtë zyrës noteriale, me vullnetin e tyre të lirë dhe që e nënshkruan në zyrën e noterisë në Vlorë.

¹⁷ Nga i cili rezulton regjistrimi me nr. {***}, datë 19.05.1999, në regjistrin e apartamenteve të hipotekës.

¹⁸ E paplotësuar.

¹⁹ Nëpërmjet së cilës, ndër të tjera, deklaronte se ajo nuk kishte ndërtuar që ajo apo pjesëtarët e familjes nuk kishin përfituar nga ligji i privatizimit, nuk kishin bërë ndërtime të tjera pa leje si shtesa, nuk kishin marrë truall për ndërtim banese që nuk i takonte sipas normativës së strehimit, banesa që privatizohej nuk kishte qenë në qiramarrje të emigrantit, nuk kishte marrë leje banimi në qytet pas datës 31.02.1992, nuk kishte përfituar nga ligji për tokën, nuk dispononte banesë tjetër shtetërore ose private në këtë qytet ose në qytet e qendra të tjera banimi, dhe nuk kishte familje tjetër me certifikatë të veçantë në apartamentin saj.

²⁰ Rezulton e përsëritur në të njëjtën praktikë.

²¹ Për privatizimin e banesës nr. {***}, rr. “{***}”, pll. {***}, sh. {***}, k. {***}, në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992.

²² E paplotësuar.

²³ Me shënim të veçantë “përbërja 2+1 RVP 4407480 lekë, datë 20.09.2016, anulohet veprimi datë 20.09.2016”.

²⁴ Rezulton e përsëritur në të njëjtën praktikë.

²⁵ Me objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare për trashëgimlënësen M. S., duke përcaktuar trashëgimtar, ndër të tjerë, edhe z. Gj. S.

²⁶ Me objekt, lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësit G. S., J. S., V. S., A. S., M. S., V. S., E. S. dhe M. S., duke përcaktuar trashëgimtar, ndër të tjerë, edhe z. J. S.

- Aplikimi nr. {***}, datë 05.01.2009, drejtuar ZVRPP Vlorë²⁷.
- Kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.12.2008, shitës znj. J. S., z. J. S.²⁸ dhe z. Gj. S.²⁹, blerëse znj. D. S., e apartamentit me sip. 74,20 m², çmimi i përbërë nga pjesa e znj. J. S. prej 1055990 lekësh, pjesa e z. J. S. prej 633594 lekësh, pjesa e z. Gj. S. prej 422396 lekësh, vlera këto të likuiduara nga palët jashtë zyrës noteriale.
- Certifikata për vërtetim pronësie, datë 09.12.2008, e ZVRPP Vlorë³⁰.
- Kartela e pasurisë së paluajtshme e ZVRPP Vlorë³¹.
- Prokura e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.07.2008³².
- Prokura e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.12.2008, të përfaqësuar z. J. S. dhe z. Gj. S., dhe përfaqësuese znj. Ana Gollosi.
- Letërnjoftimi i z. Gj. S..
- Letërnjoftimi i z. J. S..
- Pasaporta e znj. Ana Gollosi.
- Letërnjoftimi i znj. D. S..
- Letërnjoftimi i znj. D. S.³³.
- Inventari i brendshëm i dosjes.
- Kontrata nr. {***} rep., nr. kol. {***}, datë 20.10.2016³⁴.
- Pasaporta e znj. L. K..
- Certifikata për vërtetim pronësie, datë 09.01.2009, e ZVRPP Vlorë³⁵.
- Kartela e pasurisë së paluajtshme, e ZVRPP Vlorë³⁶.
- Njoftim debitimi, datë 18.10.2016, i {***}³⁷.
- Letërnjoftimi i znj. D. S..
- Kartela e pasurisë së paluajtshme, e ZVRPP Vlorë³⁸.
- Deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.10.2016³⁹.

²⁷ Blerëse znj. D. S., çmimi i shitjes sipas kontratës 2.111.980 lekë, çmimi fiskal i shitjes ap. $61,8 \text{ m}^2 \times 34156 = 211980$ lekë, çmimi i kontratës së blerjes ap. $61,8 \text{ m}^2 \times 17017 = 1.051.651$ lekë, shuma për t'u tatuar $2.111.980 - 1.051.651 = 1.060.329$ lekë, tatimi për t'u paguar $1.060.329 \times 10\% = 106.033$ lekë.

²⁸ Përfaqësuar nga znj. Ana Gollosi.

²⁹ Përfaqësuar nga znj. Ana Gollosi.

³⁰ Pasuria nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, zk {***}, adresa: lagjja "{***}", e llojit apartament, sip. totale 74,20 m², në pronësi të znj. J. S. 5/12, z. J. S. 1/4, znj. D. S. 1/4 dhe z. Gj. S. 1/6.

³¹ Pasuria nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, zk {***}, adresa: lagjja "{***}", e llojit apartament, sip. totale 74,20 m², në pronësi të znj. J. S. 5/12, z. J. S. 1/4, znj. D. S. 1/4, z. Gj. S. 1/6.

³² E përfaqësuar znj. J. S., përfaqësuese znj. K. S.

³³ Rezulton e përsëritur në të njëjtën praktikë.

³⁴ Shitëse znj. D. dhe blerëse znj. L. K.

³⁵ Pasuria nr. {***}, vol. {***}, fq. {***}, zk {***}, adresa: lagjja "{***}", e llojit apartament, sip. totale 74,20 m², me pronare znj. D. S.

³⁶ Pasuria nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, zk {***}, adresa lagjja "{***}", e llojit apartament, sip. totale 74,20 m², me pronare znj. D. S.

³⁷ Shuma e urdhëruar 4407480 lekë, A. Xh. person fizik, tjetërsim pasurie, kalon për znj. D. S. blerje apartamenti nga znj. L. K.

³⁸ Pasuria nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, zk {***}, adresa: lagjja "{***}", e llojit apartament, sip. totale 74,20 m², me pronare znj. L. K.

³⁹ Nëpërmjet së cilës z. A. D., bashkëshorti i palës shitëse znj. D. S., deklaroi se është dakord dhe jep pëlqimin e tij për lidhjen e kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.10.2016, redaktuar dhe legalizuar nga noteri A. Xh., kontratë e cila është bërë konform dëshirës dhe vullnetit të tij.

- Letërnjoftimi i z. A. D.
- Shkresë llogaritëse e tatimit për kalimin e së drejtës së pronësisë nr. {***}, datë 24.10.2016.
- Formular kërkesë për rivlerësim për individët e znj. D. S., drejtuar ZVRPP Vlorë.
- Kërkesa nr. {***}, datë 24.10.2016, e znj. D. S., drejtuar ZVRPP Vlorë⁴⁰.
- Vërtetimi i njësisë me origjinalin nr. {***} rep., datë 21.03.2019⁴¹.
- Kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.12.2008⁴², së apartamentit me sip. 74,20 m², ndërmyet shitësve znj. J. S., z. J. S.⁴³, z. G. S.⁴⁴ dhe blerëses znj. D. S., me çmim të përbërë nga pjesa e znj. J. S. prej 1055990 lekësh, pjesa e z. J. S. prej 633594 lekësh, pjesa e z. Gj. S. prej 422396 lekësh, vlera këto të likuiduara nga palët jashtë zyrës noteriale.
- Epikriza, datë 06.01.2016, e Qendrës Spitalore Universitare “{***}” (në vijim “{***}”)⁴⁵.
- Dy kompakt disqe (CD)⁴⁶.

24. Pas paraqitjes së ankimit, në datën 08.11.2019, subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, duke pretenduar se pas regjistrimit të ankimit nga ana e saj, është bërë e mundur gjetja e disa provave të reja, ka paraqitur në Kolegj parashtrime lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe dokumentet⁴⁷ që do të renditen më poshtë.

- Vërtetimi, datë 09.12.2002, i lëshuar nga Banka e {***}, Dega Vlorë⁴⁸.
- Vërtetimi nr. {***} prot., datë 17.10.2019, i lëshuar nga Qendra për Promovimin e Punësimit Nr. {***}, Athinë (në vijim “{***} Athinë”), nga ku rezulton se znj. Ana Gollosi është subvencionuar me një kompensim papunësie për periudhën 11.01.2005 - 10.01.2006, në shumën 4889,70 euro.
- Vërtetimi nr. {***} prot., datë 11.10.2009⁴⁹, i lëshuar nga {***}⁵⁰.
- Akti i ekspertimit financiar shtesë nr. {***}, datë 07.11.2019, i audituesit G. B.⁵¹.

⁴⁰ Për lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, lëshim kopje kartele të pasurisë, regjistrim i kontratave të shitjes, lëshim certifikatë pronësie.

⁴¹ Nëpërmjet të cilit vërtetohet njësia me origjinalin së kontratës nr. {***} rep., nr. {***}. kol., datë 26.10.2008.

⁴² Rezulton e përsëritur në praktikën e ZVRPP Vlorë.

⁴³ Përfaqësuar nga znj. Ana Gollosi.

⁴⁴ Përfaqësuar nga znj. Ana Gollosi.

⁴⁵ Për pacientin z. Gj. S., moshë 43 vjeç, i cili kishte dhimbje në kolonën vertebrale, që në ekzaminimet e mëtejshme imazherike {***}, {***} diagnoza {***}, dhe për të cilin rekomandohej rifillimi i mjekimit me {***} 4 ml çdo 4 javë, për një periudhë 6-mujore, si dhe marrjen në mënyrë periodike vitaminë {***}.

⁴⁶ Për të cilat subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, shpjegon se përmbajnë materiale nga dosja e Komisionit dhe, më tej, se njëri përmban elektronikisht dosjen origjinale të krijuar nga hetimi i Komisionit, që i është vënë në dispozicion nga Komisioni në datën 29.01.2019, dhe tjetri përmban dosjen e krijuar nga subjekti në funksion të rivlerësimit, të tilla si komunikimi me e-mail, pyetësorët, përgjigjet, si dhe analiza financiare për Kolegjin.

⁴⁷ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 08.11.2019.

⁴⁸ Nga ku rezulton se z. J. S. ishte titullar i depozitës nr. {***}, me gjendje 500.000 lekë.

⁴⁹ Në listimin e dokumenteve që ka bërë subjekti i rivlerësimit, datën e dokumentit e citon sipas printimit nga sistemi i bankës “10.11.2019”, ndërkohë që data e dokumentit është “11.10.2019”.

⁵⁰ Sipas të cilit znj. N. S., në vitin 2007 kishte debi 1.428.453,20 lekë dhe kredi 1.428.484,33 lekë, në vitin 2008 kishte debi 727.100,00 lekë dhe kredi 727.108,47 lekë, në vitin 2017 kishte debi 39,60 lekë dhe kredi 0,00 lekë, depozita me afat, data e fillimit 06.07.2007, data e maturimit 06.12.2007, balanca e depozitës 707.853,00 lekë, total interes 14.195,84 lekë, total tatim 1.419,58 lekë, data e fillimit 07.12.2007, data e maturimit 07.03.2008, balanca e depozitës 720.000,00 lekë, total interes 7.898,30, total tatim 789,83 lekë.

⁵¹ Sipas të cilit raporti pasuri neto/të ardhura neto rezulton të jetë llogaritur edhe në vlerën “1,76”, por jo me vlerë më të ulët.

25. Në datën 01.07.2020, subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, ka paraqitur parashtime lidhur me shkaqet e ngritura në ankim⁵², nëpërmjet të cilave rithekson se Komisioni nuk është udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke cenuar sipas saj garancitë e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuara nga neni 52 i ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit shprehet se: “Nga formulimi kushtetues i pikave 4 dhe 5 të nenit D, arrihet në konkluzionin se, kur subjekti i rivlerësimit deklaron të ardhura që janë më shumë se pasuria e ligjshme, por pa e kaluar dyfishin e saj, për të cilën nuk janë paguar detyrimet tatimore, por arrin të provojë burimin e ligjshëm të krijimit, si dhe nuk përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, ai nuk prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore dhe nuk shkarkohet”.
26. Në datën 06.07.2020, subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, ka paraqitur sërish parashtime dhe dokumente lidhur me shkaqet e ankimit⁵³, duke pretenduar se në datën 04.12.2018 ka depozituar elektronikisht në Komision dhe fizikisht më vonë dokumente justifikuese për burimin e ligjshëm të të ardhurave të saj dhe të personave të lidhur, vlera e të cilave sipas subjektit të rivlerësimit nuk është analizuar⁵⁴.

26.1. Sipas subjektit të rivlerësimit: “Nga vlerësimi i këtij dokumentacioni rezulton se vlera e të ardhurave neto të përfituara nga periudha e emigracionit në Athinë, Greqi është 129439,79 (njëqind njëzet e nëntë mijë e katërqind tridhjetë e nëntë presje shtatëdhjetë e nëntë) euro, dhe jo 91854 (nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër) euro, sikundër rezulton në vendimin e KPK-së nr. 106, datë 13.02.2009”.

26.2. Po sipas subjektit të rivlerësimit, dokumentet e paraqitura prej saj, sipas renditjes më poshtë, nuk janë analizuar nga Komisioni, ndërkohë që ajo parashton se këto dokumente janë tregues i drejtpërdrejtë i nivelit të të ardhurave⁵⁵.

- Dëshmia e sigurimeve dhe kontributeve e lëshuar nga ISSh-ja Greqi për z. Gj. S., për periudhën 2000-2002, për të cilën rezultojnë vlerat e të ardhurave dhe pagesat e kontributeve.
- Dëshmia e sigurimeve dhe kontributeve e ISSh-së Greqi për z. Gj. S., për periudhën 1998 -2000, për të cilën rezultojnë vlerat e të ardhurave dhe pagesat e kontributeve.
- Dëshmia e sigurimeve dhe kontributeve e ISSh-së Greqi për z. Gj. S., për periudhën 1996 - 1998, për të cilën rezultojnë vlerat e të ardhurave dhe pagesat e kontributeve.
- Dëshmia e sigurimeve dhe kontributeve e ISSh-së Greqi për znj. Ana Gollosi, për shpërblim leje, dhuratë Krishtlindjeje dhe periudhën dhjetor 2001, për të cilat rezultojnë vlerat e të ardhurave dhe pagesat e kontributeve.
- Dëshmitë e sigurimeve dhe kontributeve të ISSh-së Greqi për znj. Ana Gollosi, për periudhat shkurt 2000, mars 2000⁵⁶, prill 2000, maj 2000, qershor 2000, korrik 2000, gusht 2000, shtator 2000, tetor 2000, nëntor 2000, dhjetor 2000, përfshirë dhe dhuratë Krishtlindjeje, janar 2001,

⁵² Shih parashtimet e regjistruara në Kolegj me nr. {***} prot., datë 01.07.2020.

⁵³ Shih shkresën e dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 06.07.2020 dhe të regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 06.07.2020.

⁵⁴ Sipas subjektit të rivlerësimit: “Sikundër rezulton nga inventari bashkëngjitur kësaj kërkesë, me numër rendor 15 deri në 21, janë depozituar librezat e punës të cilat vërtetojnë vlerën e të ardhurave neto dhe vlerën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të subjektit, znj. Ana Gollosi, dhe të personit të lidhur, z. Gj. S., në gjuhën greke dhe me vulë apostile sipas konventës së Hagës”.

⁵⁵ Për të cilat janë paguar të gjitha detyrimet sipas legjislacionit grek, por se ishin paraqitur në gjuhën greke dhe të papërkthyer në gjuhën shqipe, dhe në këto kushte subjekti i rivlerësimit i vendos në dispozicion të përkthyer në gjuhën shqipe.

⁵⁶ Përfshirë dhuratën e Pashkëve.

shkurt 2001, mars 2001, prill 2001⁵⁷, maj 2001, qershor 2001, korrik 2001, gusht 2001, shtator 2001, tetor 2001, nëntor 2001, duke përfshirë dhe shërbim leje, periudha për të cilat rezultojnë vlerat e të ardhurave dhe pagesat e kontributeve.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

27. Për sa i përket juridiksioni i Kolegjit, në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimit të Komisionit, që në këtë rast ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi. Ankimet ndaj vendimeve të Komisionit në Kolegj shqyrtohen sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.
28. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, duke qenë subjekt rivlerësimi. Ankuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me përcaktimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016⁵⁸.
29. Në lidhje me formën dhe mënyrën e shqyrtimit, trupi gjykues i Kolegjit, me vendimin e ndërmjetëm të datës 08.07.2020, pasi mori në shqyrtim kërkesat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, për t'u marrë si prova në këtë gjykim aktet shkresore të paraqitura në Kolegj në datat 08.11.2019 dhe 06.07.2020, dhe në funksion të marrjes së këtyre provave dhe të konstatimit në mënyrë të plotë dhe të saktë të situatës faktike⁵⁹, me shumicë votash, vendosi të mos i pranohet këto kërkesa procedurale të subjektit të rivlerësimit si për sa i përket marrjes së provave të reja, ashtu edhe kalimit të gjyqësorisë në seancë gjyqësore publike, dhe bazuar në nenet 51⁶⁰, 47⁶¹ dhe 49⁶² të ligjit nr. 49/2012, vendosi që gjykimi i

⁵⁷ Përfshirë dhuratën e Pashkëve.

⁵⁸ Vendimi i Komisionit i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 15.03.2019, dhe është marrë në dorëzim prej tij në datën 18.03.2019. Në datën 01.04.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankimin pranë Komisionit. Ankimi është pranuar nga Komisioni me vendimin nr. {***}, datë 04.04.2019, që i është komunikuar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.04.2019.

⁵⁹ Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që gjykimi i çështjes të kalojë nga gjykimi në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh në seancë gjyqësore publike trupi gjykues.

⁶⁰ Neni 51 i ligjit nr. 49/2012 parashikon: "1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. 2. Vendimi i mësipërm, data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve rregullisht nga sekretaria gjyqësore, të paktën 10 ditë para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore".

⁶¹ Neni 47 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se: "Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj".

⁶² Neni 49 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se: "1. Shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. 2. Kryetari i trupit gjykues përgatit relacionin dhe cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton palët rregullisht për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes të paktën 15 ditë përpara. Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes

çështjes të vazhdonte në dhomë këshillimi, mbi bazën e akteve të administruara në fashikullin e gjykimin që Komisioni përcolli në Kolegj, sipas parashikimeve të nenit 47, pika 1 e ligjit nr. 49/2012⁶³ dhe të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2012⁶⁴.

A. Në lidhje me pretendimet për shkelje procedurale

30. Përkundër sa pretendon subjekti i rivlerësimit se Komisioni nuk ka qenë objektiv dhe ka cenuar parimin e proporcionalitetit, duke theksuar se detyrimet e ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative për deklarimin e pasurisë dhe konfliktit të interesave, nuk kanë qenë asnjëherë të njëjta me ato të subjekteve të tjera të rivlerësimit, Kolegji vlerëson se është ligji kushtetues⁶⁵ dhe jo Komisioni, ai i cili, për shkak të detyrës, ka përcaktuar rrethin e subjekteve për t’u rivlerësuar sipas procedurave të parashikuara me ligjin nr. 84/2016. Rivlerësimi në vetvete nuk është i diferencuar me bazë funksionin e subjektit të rivlerësimit, por për shkak të funksionit, është i njëjtë për çdo subjekt rivlerësimi, dhe pavarësisht funksionit të subjekteve konkrete të rivlerësimit, rivlerësimi kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore.
31. Për të arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, Kolegji, bazuar në nenet 61, pika 3 dhe 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016⁶⁶, vlerëson se subjektet e rivlerësimit jo vetëm që duhet të kenë kryer deklarim të saktë në përputhje me ligjin, duke mos u gjendur në situatë konflikti i interesit, fshehje pasurie, apo deklarim të rremë, duhet gjithashtu të mos gjenden në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë. Nga interpretimi sistematik i dispozitave kushtetuese, rezulton se qëllimi i tyre nuk është të përcaktojnë rendin e rëndësisë së deklarimeve. Verifikimi i saktësisë dhe plotësisë së deklarimeve të subjektit, verifikimi i dyfishit të pasurisë, si dhe i burimeve të ligjshme të pasurisë, duke u dhënë të gjitha deklarimeve vlerën e provës, përbëjnë në fakt kriteret në të cilat duhet të kalojë vlerësimi i pasurive të subjekteve të rivlerësimit, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës⁶⁷. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se secili nga paragrafët e nenit D të Aneksit të

parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim. 3. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor”.

⁶³ Sipas nenit 47, pika 1 e ligjit nr. 49/2012: “Shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit”.

⁶⁴ Sipas nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2012: “6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme [...]”.

⁶⁵ Neni 179/b i Kushtetutës përcakton se: “3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio. 4. Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio [...]”.

⁶⁶ Neni 61 i ligjit nr. 84/2016 përcakton se: “Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: 1). Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të. 2). Kur rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar që bën të pamundur vazhdimin e detyrës. 3). Kur rezulton se ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji. 4). Kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale. 5). Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi të drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit”.

⁶⁷ Shih pikën 12.2 të vendimit nr. 9, datë 18.04.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Kushtetutës normon një situatë të caktuar gjatë procesit të rivlerësimit të subjekteve. Konkretisht, *pika 1* parashikon qëllimin e kontrollit të pasurisë dhe të deklarimit, identifikimin e subjekteve që kanë pasuri të pajustificuar ose të subjekteve që nuk kanë deklaruar saktë dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe ato të personave të lidhur; *pika 2* parashikon detyrimin për plotësimin e saktë dhe të plotë të deklaratës *vetting* dhe detyrimin e ILDKPKI-së për të përpiluar një raport për ligjshmërinë e pasurive, saktësinë dhe plotësinë e deklarimit sipas ligjit; *pika 3* parashikon detyrimin e subjektit për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara; *pika 4* parashikon se nëse deklarohet pasuri më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, subjekti prezumohet fajtor për shkelje disiplinore dhe duhet të paraqesë prova që të vërtetojnë të kundërtën; dhe *pika 5* parashikon rastin e mosdorëzimit të deklaratës në kohë, apo përpjekjes për të fshehur, apo paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë, gjë e cila shkakton prezumimin e masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të paraqesë prova që vërtetojnë të kundërtën. Në përmbledhje, secila prej këtyre pjesëve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon një element specifik dhe të pavarur nga të tjerët, “pavarësi” e cila pasqyrohet në përcaktimet e masave disiplinore sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Konkretisht, ky nen zberthen secilën prej pikave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke e materializuar sanksionimin kushtetues edhe me përcaktimin konkret të shkeljes. Më konkretisht, *pika 1* e nenit 61 përcakton si shkelje “deklarimin më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të”; *pika 2* përcakton si shkelje “problemet serioze që lidhen me ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar”, çka ndikon në kontrollin e figurës; *pika 3* përcakton si shkelje “pamjaftueshmërinë për kriterin e kontrollit të figurës” dhe “pamjaftueshmërinë për kriterin e kontrollit të pasurisë”; *pika 4* “përshtatshmërinë për shkak të nivelit të aftësive profesionale”; dhe *pika 5* përcakton si shkelje “cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë”. Sikurse rezultojnë nga ky zberthim, pikat 3 dhe 4 të nenit D të Kushtetutës janë pasqyruar në parashikimet 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, të cilat pasqyrojnë dy raste të veçuara nga njëri-tjetri, ku njëri lidhet me dyfishin e pasurisë së ligjshme dhe tjetri me pamjaftueshmërinë e pasurisë. Të dyja këto raste rrjedhin nga situata specifike të veçanta dhe nuk mund të konsiderohet se zbatohen në mënyrë kumulative⁶⁸.

32. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit ka karakter deklarativ dhe nuk është i bazuar në prova, Kolegjit i rezultojnë se Komisioni ka arritur në përfundime pasi fillimisht ka marrë në shqyrtim saktësinë dhe plotësinë e deklaratave në deklaratën *vetting*, justifikimin me burime të ligjshme të pasurive të deklaruara, sikurse edhe të pasurive që rezultuan pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, duke kryer në këtë mënyrë hetim të plotë dhe të gjithanshëm⁶⁹. Aspektet e jetës së subjekteve të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me ta, apo edhe specifikat në zhvillimet ekonomike, ndikojnë në objektin e vlerësimit të pasurive, për aq sa këto ngjarje shoqërore sjellin rrethana konkrete për çështjen konkrete, sipas objektit të përcaktuar në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016⁷⁰.

⁶⁸ Shih pikën 22.15 të vendimit nr. 19, datë 26.07.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁶⁹ Nga *pika V* e vendimit rezultojnë se: “Trupi gjyqësor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se: [...]”.

⁷⁰ Sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është i kufizuar në deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

33. Kolegji vlerëson se pretendimi i përgjithshëm për mënyrën e vlerësimit të pasurive dhe llogaritjes së vlerës së pasurisë, për sa kohë që nuk vërtetohen shkaqe që venë në dyshim garantimin e paanësisë të anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit, nuk mund të konsiderohen si të justifikuar objektivisht. Lidhur me qëndrimin e paanshëm të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit të subjekteve, Kolegji tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar referuar jurisprudencës së GjEDNj-së⁷¹. Kjo e fundit është shprehur se për të vendosur në një çështje të dhënë, mbi ekzistencën e një arsyeje të justifikuar për të dyshuar se në një trup gjykues mungon paanshmëria, duhet përcaktuar nëse, pavarësisht nga sjellja personale e njërit prej anëtarëve të trupit gjykues, ekzistojnë fakte të verifikueshme që lejojnë të dyshosh në paanshmërinë e vetë trupit gjykues. Pra, për të vendosur, në një çështje të dhënë, mbi ekzistencën e një arsyeje të justifikuar për të dyshuar për mungesë paanshmërie të një gjyqtari (*Morel kundër Francës*, §§ 45-50; *Pescador Valero kundër Spanjës* § 23) ose të një trupi gjykues (*Luka kundër Rumanisë*, § 40), këndvështrimi i një personi të interesuar merret parasysh, por nuk luan rol vendimtar. Përcaktuese është të zbulohet nëse shqetësimet e të interesuarit mund të konsiderohen si të justifikuar objektivisht (*Wettstein kundër Zvicrës* §44; *Pabla Ky kundër Finlandës* §30; *Micalleff kundër Maltës [Dhoma e Madhe]*, §96)⁷². Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron.
34. Përkundër sa pretendon subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, se pasuritë e krijuara nga subjektet e rivlerësimit, përfshirë dhe personat e lidhur, përpara fillimit të detyrës nuk mund dhe as duhet të jenë objekt verifikimi në kuadër të ligjit nr. 84/2016, Kolegji vlerëson se nëpërmjet procesit të rivlerësimit shqyrtohet e shkuara e subjekteve të rivlerësimit.
- 34.1. Rivlerësimi është analizë e së shkuarës së një funksionari publik, duke mbajtur në konsideratë që objekt kontrolli është pasuria dhe për këtë shkak institucionet e rivlerësimit kontrollojnë burimin në të shkuarën, për të cilin është krijuar kjo pasuri, dhe rivlerësimi *vetting*, mund të përkufizohet si vlerësim i integritetit për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksione publike⁷³.
- 34.2. Në një interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurive, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit ka arritur në konkluzionin se, nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj.
- 34.3. Në lidhje me pretendimin e krijimit të pasurive jo si pasojë e korrupsionit dhe abuzimit me detyrën, Kolegji vëren se dispozitat kushtetuese dhe ligjore të posaçme, që rregullojnë procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë, në asnjë rast nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklarimit me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit në kuptimin penal të këtyre instituteve (korrupsionit dhe abuzimit me detyrën). Në këtë proces, subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit

⁷¹ Shih pikën 29.10 të vendimit nr. 3, datë 04.03.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁷² Shih https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_ENG.pdf – paragrafi 242.

⁷³ Shih par. 39 të vendimit nr. 19/2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

të Kushtetutës, i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij dhe organet e rivlerësimit kanë si qëllim që të identifikojnë ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur⁷⁴.

35. Sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës⁷⁵, është detyrim i subjekteve të rivlerësimit të vërtetojnë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive dhe të ardhurave të deklaruara, pavarësisht kohës së krijimit.

36. Përkundër sa pretendon subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Golloshi, se vlerësimi i raporteve pozitive të shërbimeve të inteligjencës dhe mjaftueshmërisë së përgatitjes profesionale duhet të ishin pranuar si të mjaftueshme nga Komisioni, për të arritur konkluzionin që nuk ka deklarim të pavërtetë, Kolegji vlerëson se, për efekt të procesit të rivlerësimit, neni 4 i ligjit nr. 84/2016, por edhe nenet e tjera të tij, nuk parashikojnë urdhërime ndaluese që të pengojnë kryerjen e procesit të rivlerësimit të subjektit dhe disponimin e organeve të rivlerësimit në lidhje me të, bazuar vetëm në një kriter⁷⁶.

36.1. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se masa e shkarkimit mund të vendoset nëse plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe të pasurisë, bie ndesh me nenin 4, pika 2, fjalia e dytë e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon alternativat e vendimmarrjes bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave, alternativa të cilat mund të jenë edhe separate, përveç se kumulative⁷⁷.

36.2. Parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 nuk interpretohen të shkëputura, por në harmoni me përcaktimet e tjera ligjore, sikurse neni 4, pika 2, fjalia e dytë dhe neni 59⁷⁸, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

36.3. Për efekt të konfirmimit në detyrë, sipas parashikimeve të nenit 59, pika 1, dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duhet që në përfundim të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit duhet që bashkërisht të arrijë nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe kontrollit të figurës, si dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, dhe të vlerësimit tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të mos rezultojë se ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe që të ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

37. Përkundër sa pretendon subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Golloshi, se mungesa e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë sipas shkronjës “b”, pika 5 e nenit 33, mund të përbëjë “deklarim të pamjaftueshëm” në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, vetëm

⁷⁴ Shih pikën 56.2 të vendimit nr. 34/2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁷⁵ Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës përcakton se: “3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave [...]”.

⁷⁶ Shih pikën 25 të vendimit nr. 1, datë 31.01.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁷⁷ Neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “[...] Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”.

⁷⁸ Neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përcakton se: “1. Konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet e mëposhtme: a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; b) kur arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; c) kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale”.

nëse është në atë nivel të rëndë shkeljeje, të krahasueshëm ose të barabartë me “fshehjen e pasurisë”, sipas shkronjës “c”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, me “deklarimin e rremë”, sipas shkronjës “ç”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ose me “situatën e konfliktit të interesit”, sipas shkronjës “d”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për efekt të procesit të rivlerësimit, përcaktimet e shkronjave “b”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji vlerëson se nuk janë shkaqe të krahasueshme me njëra-tjetrën apo të ndërvarura nga njëra-tjetra për marrjen e masës së shkarkimit nga detyra, përkundrazi ato janë shkaqe të pavarura në drejtim të marrjes së masës disiplinore të shkarkimit.

38. Kolegji vëren se vendimi nr. 106, datë 13.02.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në pikën V përmban nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që para pjesës urdhëruese përmbahen nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe neni 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesat e nenit 57, pika 4, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, çka do të thotë që Komisioni, pasi ka renditur nominalisht rrethanat e faktit, i ka përmbledhur në të njëjtat baza ligjore për shkak gjetjeve të konstatuara me natyrë të ngjashme. Elementet përmbajtësore të vendimit të Komisionit, përfshirë edhe dispozitat ligjore, gjejnë përcaktim në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit Komisioni, pasi të ketë arsytuar në lidhje me rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues, me provat dhe arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi, si dhe me raportin/rekomandimin e relatorit, ka për detyrim të shprehet edhe për dispozitat ligjore në të cilat mbështet vendimin.

39. Të pabazuar e vlerëson Kolegji edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, se marrja, administrimi, hetimi kryesisht në lidhje me pasurinë, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit për këtë të fundit nga i njëjti trup gjykues i Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit edhe “organ akuzator”, edhe “gjykatë”, cenon haptazi parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, për efekt të një procesi të rregullt, pasi Komisioni ka ushtruar ato kompetenca për të cilat e ka autorizuar ligji. Komisioni është një organ kushtetues i pajisur me autoritet vendimmarrës, i pajisur me kompetencat për të kryer “një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi”⁷⁹, pasi të ketë administruar raportin e ILDKPKI-së dhe të ketë kryer vetë hetimin administrativ për të arritur në përfundime.

39.1. Mbledhja e provave, vlerësimi i tyre dhe vendimmarrja përfundimtare është kompetencë të cilën ligji ia ka njohur shprehimisht trupit gjykues të Komisionit, të caktuar sipas shortit përkatës, konkretisht nga neni Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, nenet 45, 49, 51, 57 të ligjit nr. 84/2016.

39.2. Pretendimi për cenimin e nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, në koncept, nuk mund të bazohet në shkeljen e pavarësinë dhe paanësinë e tribunaleve vendimmarrëse ose në shkeljen e garancive thelbësore procedurale nëse vendimi është marrë nga trupi gjykues i një tribunali me juridiksion të plotë dhe duke siguruar respektimin e garancive përkatëse⁸⁰.

⁷⁹ Shih pikat 40 - 41 të vendimit nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

⁸⁰ Shih vendimet e GjEDNj-së De Haan kundër Holandës, par. 52-55, Helle kundër Finland, par. 46, Crompton kundër Mbretërisë së Bashkuar, par. 79 dhe Denisov kundër Ukrainës, par. 65, 67 dhe 72.

40. Në lidhje me bashkëpunimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016⁸¹, Kolegjit nuk i rezulton mungesë gatishmërie e subjektit të rivlerësimit, por se ndikimi i kohëzgjatjes ka ardhur si pasojë e procedurave për grumbullimin nga subjekti i rivlerësimit të dokumentacionit në shtetin grek, dhe në vijim legalizimin dhe përkthimin në gjuhën shqipe.

40.1. Kolegji vëren se në përgjigje të pyetësorit 1, të dërguar nga Komisioni në datën 14.09.2018, për të cilin Komisioni kishte përcaktuar afatin 10-ditor, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur brenda afatit të caktuar, përkatësisht në datën 24.09.2018, ndërkohë që një ditë më parë, subjekti i rivlerësimit kishte dërguar elektronikisht edhe dokumentacionin përkatës. Në lidhje me pyetësorin 2, datë 25.09.2018, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur në datën 18.10.2018⁸², ndërkohë që në datën 11.11.2018 ka dërguar elektronikisht një pjesë të dokumentacionit dhe pjesën tjetër në datën 16.01.2019.

41. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka mbajtur fare parasysh faktin se ky dokumentacion ishte mjaft i hershëm, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhet të provojë se ka bërë të gjitha përpjekjet për ta pasur dokumentin dhe nuk ka arritur ta zotërojë për arsye që nuk varen prej tij, në kuptim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

42. Përkundër pretendimit të subjektit të rivlerësimit se nga dokumentacioni i marrë me kompakt disk (CD) nga Komisioni, nuk është shkarkuar asnjë dokument nga i gjithë dokumentacioni voluminoz i dërguar elektronikisht më datë 16.01.2019, Kolegji vlerëson se subjektit të rivlerësimit i janë dorëzuar ato akte që Komisioni ka mbledhur nga hetimi, dhe jo aktet e dorëzuara prej vetë subjektit të rivlerësimit.

- Për sa u përket dokumenteve konkrete, në vijim të komunikimit elektronik të subjektit të rivlerësimit, Kolegjit i rezulton se në fashikullin nr. 8 të dosjes së Komisionit, është administruar dokumentacioni i dërguar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, nëpërmjet komunikimit elektronik me *e-mail-in* e datës 16.01.2019.

43. Kolegji vëren se përkundër sa pretendon subjekti i rivlerësimit në lidhje me mosarsyetimin e mospërfshirjes së të ardhurave të znj. N. S., Komisioni në faqen 15 të vendimit ka arsyetuar se: “[...] Komisioni në analizën financiare nuk ka përfshirë të ardhurat e përfituara prej tyre nga pensioni i pleqërisë, por gjithashtu nuk ka përfshirë në llogaritje shpenzimet e tyre për jetesë, duke vlerësuar se të ardhurat nga pensioni mund të mbulojnë vetëm shpenzimet minimale të jetesës. Komisioni, me dërgimin e rezultateve të hetimit në asnjë rast nuk ka vënë në dyshim se znj. N. S. dhe i ndjeri, z. J. S., kanë jetuar në shtetin grek së bashku me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e subjektit. Për këto arsye, bazuar në shkronjën “d” të pikës 5 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues me anë të vendimit të ndërmjetëm nr. 3, datë 31.01.2019, ka vendosur të refuzojë kërkesën e paraqitur nga subjekti, pasi ka vlerësuar se me anë të kësaj kërkesë pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit. Si përfundim, Komisioni ka vlerësuar

⁸¹ Komisioni ka vlerësuar se: “20. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, nuk ka treguar gatishmëri gjatë procesit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, duke dërguar deklaratimet e saj dhe provat përkatëse jashtë afateve të përcaktuara, gjë që ka çuar në vonesën e procesit të rivlerësimit”.

⁸² Pasi Komisioni, në datën 15.10.2018, i kishte bërë me dije subjektit të rivlerësimit shkresën nr. {***} prot., datë 09.10.2018, të MEPJ-së, në lidhje me legalizimin e dokumenteve me vulë apostile, dhe në datën 16.10.2018, i kishte lënë afatin 5-ditor për t’u përgjigjur për pyetësorin nr. 2.

se nuk do të përfshijë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga pensioni i pleqërisë nga znj. N. S. dhe z. J. S.. Kolegji konstaton se Komisioni nuk ka llogaritur pensionet e marra, duke i konsideruar ato si shpenzime jetese minimale të kryera nga znj. N. S. dhe z. J. S., ndërsa subjekti i rivlerësimit, sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, kishte barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e vlerësimit të Komisionit⁸³. Gjithashtu, sipas analizës së kryer në Kolegj, edhe sikur të llogariteshin pensionet e pleqërisë së znj. N. S. dhe z. J. S., ato nuk ndryshojnë apo ndikojnë në konkluzionin për mungesë të burimeve të ligjshme. Ashtu sikurse dhe në analizat financiare referuar akteve te ekspertimit, paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit në ankim, në variantin ku janë përfshirë të ardhurat nga pensionet, rezulton me raportin e pasurive neto me të ardhurat neto në vlerën “1,74”, pra subjekti i rivlerësimit rezulton me një diferencë negative për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive me të ardhura të ligjshme prej 13.696.402 lekësh (si diferencë e të ardhurave neto 01.07.1996 - 27.01.2017 me pasuri të blera dhe të krijuara 01.07.1996 - 27.01.2017), pra me mungesë burimesh të ligjshme⁸⁴.

44. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se metodologjia e përdorur nuk është veçse një rregullore e përgjithshme që nuk ka asnjë vlerë për analizën financiare të kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se Komisioni i ka njoftuar subjektin të rivlerësimit mënyrën e kryerjes së analizës financiare, në drejtim të vlerave të aktivitetit, mjeteve monetare, detyrimeve/shlyerjeve, të ardhurat neto, si dhe shpenzimet për shkollim, sikurse ato janë konkretizuar në analizën financiare përfundimtare⁸⁵.
45. Komisioni ka detyrim që të arrijë në përfundime bazuar në fakte, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, se Komisionit nuk i nevojiteshin indiciet indirekte kur kishte prova të forta të pakontestueshme se të ardhurat e sjella nga emigracioni ishin më të larta se sa ato të evidentuara me dokumentacion justifikues ligjor, për sa kohë që nga dokumentet e administruara në Komision, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultojnë me pamjaftueshmëri burimesh për të justifikuar pasuritë e deklaruarat⁸⁶. Kolegjit i rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur janë pajisur me leje qëndrimi dhe pune në Greqi, por për efekt të procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin 32, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin për të paraqitur të gjitha dokumentet që justifikonin vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, ose të vërtetonte pamundësinë objektive për të disponuar dokumentin. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se rrethanat që subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, parashtroi, vërtetojnë se ajo i dispononte këto pasuri, por se këto rrethana nuk vërtetojnë mënyrën e krijimit të tyre.

⁸³ Neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “2. Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën”.

⁸⁴ Shih f. 35 - 36 të ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi.

⁸⁵ Shih f. 1280 - 1281 të dosjes së Komisionit.

⁸⁶ Sipas subjektit të rivlerësimit, ku mund ta gjenim shumën prej 22.819 eurosh më tepër nga të ardhurat neto, përveç se nga puna në emigracion e të katër anëtarëve të aftë për punë, z. Gj. S., z. J. S., znj. N. S. dhe asaj vetë, dhe sipas saj nuk ka provë më të fortë se kontrata e sipërmarrjes dhe kontrata shtesë e sipërmarrjes që vërtetojnë se niveli i të ardhurave të tyre nga emigracioni ishte më i lartë, duke qenë se bashkëshorti i saj kishte emigruar që në shkurt të vitit 1994, prindërit e tij në korrik të vitit 1995 dhe ajo në shkurt të vitit 1997.

46. Kolegji vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se vlera e depozitave ka qenë në masën që e lejonte neni 5 i ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002, “Për sigurimin e depozitave”, nuk vërteton ligjshmërinë e krijimit të këtyre depozitave, sikurse dhe plotësimi i kushteve për marrjen e shtetësisë greke, përfshirë edhe kushtin që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj të mos kishin kryer vepra penale, nga kryerja e të cilave të kishin përfituar të ardhura në mënyrë të paligjshme, nuk vërteton ligjshmërinë e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, sipas nenit D, pika 3, fjalia e parë e Aneksit të Kushtetutës.

B. Pretendime për konstatim të gabuar të gjendjes faktike

47. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, pretendoi se në analizën financiare të Komisionit janë përfshirë shpenzime që nuk janë kryer, ndërkohë që nuk janë përfshirë në analizën financiare të gjitha të ardhurat e ligjshme, për sa i përket llogaritjes së kontributit të saj në krijimin e pasurisë/apartament në Tiranë, mospërfshirjes në analizën financiare të të ardhurave nga asistenca e papunësisë në Greqi, mosllogaritjes së të ardhurave të z. J. S. dhe z. Gj. S. nga kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.12.2008, mospërfshirjes së të ardhurave të punësimit të z. Gj. S. pranë {***}-së, si dhe mosllogaritjen e pensioneve të pleqërisë së znj. N. S. dhe z. J. S., sikurse do të renditen më poshtë.

48. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, se nuk kishte kontribut në krijimin e pasurisë/apartament në rr. “{***}”⁸⁷, Kolegji vëren se apartamenti i banimit është porositur nga z. N. G., në emër dhe për llogari të të gjithë bashkëpronarëve të tjerë.

48.1. Z. N. G., përveçse porosites i apartamentit, ka vepruar edhe si përfaqësues pa tagër i bashkëpronarëve të tjerë, znj. S. G., znj. Ana Gollosi, z. S. G. dhe znj. O. G., sipas parashikimeve të nenit 78 të KCivil⁸⁸.

48.2. Nga kontrata e sipërmarrjes, datë 22.03.2002⁸⁹, rezulton se sipërmarrësi Filia {***} ShPK kishte lidhur marrëveshje me z. N. G. për ndërtimin e apartamentit me sip. 82,45 m², shk. {***}, k. {***}, në Rrugën e {***}, pranë {***}, në shumën 28.033 USD, shumë e cila ishte parashikuar për t’u shlyer si në vijim: i) 21.305 USD në datën 25.03.2002; ii) 5326 USD në datën 02.06.2002; dhe iii) 1402 USD në dorëzimin e apartamentit.

48.3. Nga kontrata e shitblerjes pasuri e paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***}3826 kol., datë 02.12.2011, rezulton se shoqëria Filia {***}ShPK u ka shitur blerësve, z. N. G., znj. S. G., znj.

⁸⁷ Në bashkëpronësi me 1/5 secili Ana Gollosi, N. G., S. G., S. G. dhe O. G., subjekti i rivlerësimit parashtron se bie ndesh me KPrCivile, nenet 253 e në vijim, dhe se nëse dokumentacioni i privatizimit që ka shërbyer për fitimin e pronësisë mbi këtë banesë dhe kontratat e shitblerjes, apo kontrata e sipërmarrjes së apartamentit, kanë karakter deklarativ dhe nuk quhen prova, atëherë kjo trupë gjyquese nuk është në gjendje të kuptojë se çfarë është prova, në kuptimin e saj, cilat dokumente përbëjnë provë të plotë, çfarë synohet të provohet nëpërmjet tyre, fuqinë provuese të kontratave, e cila vetëm për atë të lidhur në vitin 2011 nga 5 anëtarët e familjes Gollosi paska forcën e ligjit (sipas arsyetimit të Komisionit), ndërsa kontrata e sipërmarrjes e vitit 2002 dhe të tjerat më të hershme nuk paskan të njëjtën fuqi provuese.

⁸⁸ Neni 78 i KCivil, përcakton se: “Kur një person fizik ose juridik vepron si përfaqësues pa e pasur këtë cilësi, si edhe kur përfaqësuesi ka kapërcyer tagrat që i janë dhënë, veprimi juridik i kryer në këto kushte nuk është i detyrueshëm për personin në emrin e të cilit janë kryer, përveç kur ky e ka miratuar atë më vonë [...]”.

⁸⁹ Për kontratën e sipërmarrjes janë vërtetuar nënshkrimet nëpërmjet veprimit noterial nr. {***} rep., {***} kol., datë 22.03.2002.

Ana Golloshi, z. S. G. dhe znj. O. G., apartamentin nr. {***}, k. {***}, godina {***}, rr. “{***}”, sh. {***}, me sip. 71,5 m². Shprehimisht nga kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.12.2011, rezulton se: “Palët si më lart, në marrëveshje mes tyre, kanë rënë dakord që ky apartament t’u kalojë blerësve, z. N. G., znj. Ana Golloshi, z. S. G. dhe znj. O. G., sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.03.2002, para notere L. Gj. të jetë në shumën 28033 (njëzet e tetë mijë e tridhjetë e tre) dollarë amerikanë. Kjo shumë, sipas deklaramit të palëve dhe vërtetimit nga dokumentet përkatëse të pagesës, rezulton të jetë paguar jashtë kësaj zyre noteriale, pa asnjë pretendim tjetër të mëtejshëm financiar, në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes.

48.4. Pronësia mbi apartamentin në rr. “{***}”, Tiranë, është fituar me anë të kontratës së shitjes, e cila ka forcën e ligjit⁹⁰ për porositësin, z. N. G., dhe blerësit bashkëpronarë, z. N. G., znj. Ana Golloshi, z. S. G. dhe znj. O. G., për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë⁹¹.

48.5. Kolegji, në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Golloshi, se është e drejta e çdo shtetasi të rregullojë dhe përcaktojë në mënyrë të pavarur dhe sipas vullnetit të tij regjimin pasuror të pronësisë mbi një objekt të caktuar, dhe nuk është detyrë, as përgjegjësi dhe as në vullnetin e trupit gjykues të Komisionit, të përcaktojë se si do të thirren në trashëgimi fëmijët e Naum dhe S. G.⁹², vlerëson se fitimi i pronësisë me kontratë⁹³ dhe fitimi i pronësisë me trashëgim⁹⁴ janë dy institute të ndryshme të parashikuara nga KCivil. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Golloshi, rezulton të jetë bërë bashkëpronare nga shitblerja e apartamentit dhe, si pasojë, të drejtat dhe detyrimet për të rregullohen nga kjo marrëdhënie.

48.6. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Golloshi, se mospërfshirja në deklaratën *vetting* e togfjalëshit “të babait tim” apo “të prindërve të mi” nuk e bën automatikisht kontribuuese, por se ka qenë një pakujdesi e saj gjatë plotësimit të deklaratës⁹⁵, Kolegji vëren se Komisioni ka arritur në përfundimet se ajo është bashkëpronare me 20%, kontribuuese dhe pjesëmarrëse në të drejta dhe detyrime, bazuar nga sa vërtetohet nga kontrata e sipërmarrjes datë 22.03.2002 dhe nga kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., 02.12.2011, pa u kufizuar në sa janë deklaruar në deklaratën *vetting*. Kolegji vlerëson se me të drejtë subjekti i rivlerësimit pretendon se pasaktësitë në deklaram, sikurse mospërfshirja në deklaratën *vetting* e togfjalëshave të sipërcituar, nuk e bëjnë automatikisht kontribuuese. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se konkluzioni mbi bashkëpronësinë me 20% mbi këtë pasuri të paluajtshme, të drejtat dhe detyrimet mbi këtë pasuri, rezultojnë nga vlerësimi në tërësi i rrethanave të kontratës së sipërmarrjes, datë 22.03.2002, dhe i kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.12.2011.

⁹⁰ Neni 690 i KCivil përcakton: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”.

⁹¹ Neni 199 i KCivil, paragrafi i dytë përcakton: “Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta. Të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronarëve caktohen në përpjesëtim me pjesët përkatëse”.

⁹² Subjekti i rivlerësimit vijon gjithashtu se trupi gjykues nuk mund të përcaktojë nëse ata duan të disponojnë pasurinë e tyre të vetme të paluajtshme me dëshmi trashëgimie ligjore apo testamentare apo të lidhin një kontratë dhurimi në favor të fëmijëve të tyre.

⁹³ Neni 164 i KCivil, përcakton: “Pronësia fitohet me anë të kontratës, pa qenë e nevojshme të bëhet dorëzimi i sendit. Për sendet që përcaktohen në numër, në peshë ose me masë, duhet të bëhet edhe dorëzimi i tyre”.

⁹⁴ Neni 165 i KCivil, përcakton: “Fitimi i pronësisë me trashëgim kryhet sipas kushteve të parashikuara në dispozitat e pjesës së tretë të këtij Kodi”.

⁹⁵ Subjekti i rivlerësimit shpjegon se ka hasur vështirësi në atë periudhë me mbledhjen e dokumentacionit provues dhe se ka qenë pakujdesi nga ana e saj, që nuk ka specifikuar kontributin e prindërve.

49. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, se nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga asistenca e papunësisë në Greqi, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur në formën e kërkuar nga ligji dokumentet që vërtetonin vlerën e kësaj të ardhure.

49.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar para Komisionit se nuk i ka llogaritur të ardhurat e përfituara nga asistenca për periudhën 07.01.2005 - 10.01.2006, duke paraqitur për këtë qëllim shkresën e datës 11.01.2019 të Zyrës së Punës Athinë, Greqi, sipas së cilës konfirmohej për Komisionin fakti se kishte përfituar asistencë për këtë periudhë, por jo vlera e asistencës së përfituar.

49.2. Shkresën e mësipërme, subjekti i rivlerësimit e ka shoqëruar me deklaratën noteriale të datës 16.01.2019, nëpërmjet së cilës subjekti i rivlerësimit pretendonte se për këtë periudhë ka përfituar 350 euro në muaj, në total 4.900 euro, për të cilën Komisioni vlerësoi se ishte e natyrës deklarative dhe se shumata e deklaruar si e përfituar nga asistenca nuk mbështetej në dokumentacion provues dhe si rrjedhojë Komisioni vlerësoi të mos e përfshinte në analizën financiare⁹⁶.

49.3. Kolegji vëren gjithashtu se pavarësisht që në ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, ka pretenduar se dokumentacioni është asgjësuar apo se të dhënat janë parashkruar pasi kanë kaluar mbi 10 vjet, së bashku me dokumentet bashkëlidhur parashtrimeve të datës 08.11.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegji vërtetimin nr. {***} prot., datë 17.10.2019, të lëshuar nga Qendra për Promovimin e Punësimit Nr. {***} (në vijim “{***}”), Greqi, nga ku rezulton se ajo është subvencionuar me një kompensim të rregullt papunësie, për periudhën 11.01.2005 - 10.01.2006, për 300 ditë sigurimi, gjithsej 4889,70 euro.

49.4. Në kuptim të neneve 49, pika 5, shkronja “d” dhe 51 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji vlerëson se edhe nëse do të llogariteshin si të ardhura të ligjshme vlera e subvencionimit nga {***} Greqi, ajo nuk ndikon në rezultatin financiar për sa i përket mungesës së burimeve të ligjshme.

50. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, për t’u llogaritur të ardhurat e z. J. S. në shumën prej 633.594 lekësh dhe të z. Gj. S. në shumën prej 422.396 lekë, nga kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.12.2008, Kolegji vëren se ato përbëjnë të ardhura të ligjshme, pas zbritjes së tatimit mbi kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, por se ato nuk janë paraqitur në afat, dhe as provohet nga ana e subjektit të rivlerësimit pamundësia për t’i paraqitur këto prova në shqyrtimin e çështjes në Komision. Për më tepër, që në këtë kontratë shitjeje, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë vepruar në cilësinë e përfaqësueses, me prokurë të shitësve, z. J. S. dhe z. Gj. S.. Pranueshmëria e provave të reja në Kolegji është e kushtëzuar nga neni 49 i ligjit nr. 84/2016 dhe nga nenet 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012.

50.1. Duke e vlerësuar në tërësi, në kuptim të neneve 49, pika 6, shkronja “d” dhe 51 të ligjit nr. 84/2016, pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka mbajtur mend të ardhurat nga kontrata

⁹⁶ Shih f. 14, pika “iii” e vendimit të Komisionit.

e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.12.2008⁹⁷, për shkak se ishte deklarata e parë e konfliktit të interesave, koha e shkurtër, apo dhe materialet voluminoze⁹⁸, Kolegji vlerëson se edhe nëse do të llogariteshin si të ardhura të ligjshme pjesa e çmimit të përfituar nga z. J. S. dhe z. Gj. S. nga kontrata e mësipërme, ajo nuk ndikon në rezultatin financiar për sa i përket mungesës së burimeve të ligjshme.

51. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, për t'u përfshirë në të ardhurat e punësimit të z. Gj. S. pranë {***}-së, Kolegji vëren se nëpërmjet kontratës nr. {***} prot., datë 21.02.2014, punëmarrësi, z. Gj. S., ka lidhur kontratë pune me punëdhënësin {***}, me qëllim për të kryer detyrën e ekspertit mjeko-ligjor të jashtëm në kryerjen e ekspertimeve mjeko-ligjore, me afat 1-vjeçar.

51.1. Z. Gj. S. në këtë kontratë rezulton të jetë i punësuar në cilësinë e punëmarrësit/individ, dhe jo duke ofruar shërbime me cilësinë e subjektit tregtar dhe, për pasojë, paga dhe pagesat e tjera janë të ardhura të ligjshme, duke përjashtuar dietat, të cilat kanë pasur për objekt shpenzimet e kryera gjatë ofrimit të punës.

51.2. Duke i vlerësuar në tërësi, në kuptim të neneve 49, pika 6, shkronja “d” dhe 51 të ligjit nr. 84/2016, pretendimin e subjektit të rivlerësimit në të ardhurat e punësimit të z. Gj. S. pranë {***}-së, Kolegji vlerëson se edhe nëse do të llogariteshin këto të ardhura të z. Gj. S., të marra nga {***}-ja, vlera e tyre nuk ndikon në rezultatin financiar për sa i përket mungesës së burimeve të ligjshme.

52. Gjithashtu, Kolegji në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, për t'u përfshirë në llogaritjen e të ardhurave, pensionet e pleqërisë së znj. N. S. dhe z. J. S., duke i vlerësuar në tërësi, në kuptim të neneve 49, pika 6, shkronja “d” dhe 51 të ligjit nr. 84/2016. Kolegji vlerëson se edhe nëse do të llogariteshin, ato nuk ndikojnë në rezultatin financiar për sa i përket mungesës së burimeve të ligjshme.
53. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive⁹⁹, duke vlerësuar pasurinë neto në vlerën 32950.240 lekë, nga e cila ka arritur të justifikojë me të ardhura të ligjshme më pak se gjysmën e kësaj pasurie, përkatësisht vetëm shumën prej 14.180.311 lekësh, që përfaqëson të ardhurat neto.
54. Kolegji, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016¹⁰⁰, duke vlerësuar në tërësi të ardhurat e ligjshme, të pranuar si të tilla nga Komisioni, dhe të ardhurat e papërfshira në analizën financiare në Komision, sipas shkaqeve të ankimit, vëren se qëndron përfundimi i arritur nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pasi ka mungesë të burimeve financiare të

⁹⁷ Subjekti i rivlerësimit shpjegon se nuk kanë mundur të kujtojnë një veprim të kryer vite më parë, i cili vërteton se babai i bashkëshortit të saj, z. J. S., dhe bashkëshorti i saj, z. Gj. S., kanë përfituar të ardhura nga një kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme të ndodhur në qytetin e Vlorës.

⁹⁸ Neni 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përcakton: “1. Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së”.

⁹⁹ Shih pikën 27 të vendimit nr. 106, datë 13.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

¹⁰⁰ Neni 51 i ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Në rast se subjekti i rivlerësimit nuk paraqet provat, sipas nenit 85, të KPAAdministrative, si dhe kur provat që disponojnë janë të paplota, Komisioni ose Kolegji i Apelit mund të vendosin bazuar në provat që disponojnë, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e tyre të brendshme”.

ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive në emrin e saj dhe personit të lidhur me të, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

C. Pretendime për zbatim të gabuar të ligjit

55. Në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, se niveli bazë për të llogaritur mospasjen e përgjegjësisë fillon nga koncepti *pasuri e ligjshme* deri në dyfishin e vlerës, Kolegji vlerëson se neni 61 i ligjit nr. 84/2016 ka përcaktuar si shkak shkarkimi nga detyra të subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, jo vetëm “kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të”, por edhe “kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të [...] pasurisë, sipas parashikimeve të neneve [...] 33 të këtij ligji”.
56. Në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, secila prej pjesëve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon një element specifik dhe të pavarur nga të tjerët, “pavarësi” e cila pasqyrohet në përcaktimet e masave disiplinore sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Konkretisht, ky nen zberthen secilën prej pikave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke e materializuar sanksionimin kushtetues edhe me përcaktimin konkret të shkeljes. Më konkretisht, pika 1 e nenit 61 përcakton si shkelje “deklarimin më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të”; pika 2 përcakton si shkelje “problemet serioze që lidhen me ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar”, çka ndikon në kontrollin e figurës; pika 3 përcakton si shkelje “pamjaftueshmërinë për kriterin e kontrollit të figurës” dhe “pamjaftueshmërinë për kriterin e kontrollit të pasurisë”; pika 4 “përshtatshmërinë për shkak të nivelit të aftësive profesionale”; dhe pika 5 përcakton si shkelje “cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë”. Sikurse rezulton nga ky zberthim, pikat 3 dhe 4 të nenit D të Kushtetutës janë pasqyruar në parashikimet 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, të cilat pasqyrojnë dy raste të veçura nga njëri-tjetri, ku njëri lidhet me dyfishin e pasurisë së ligjshme dhe tjetri me pamjaftueshmërinë e pasurisë. Të dyja këto raste rrjedhin nga situata specifike të veçanta dhe nuk mund të konsiderohet se zbatohen në mënyrë kumulative¹⁰¹.
- 56.1 Komisioni/Kolegji, në rastet kur vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, vendos për pasojën e shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, jo për shkak të ligjit, sikurse në rastin e deklaramit të më shumë se dyfishit të pasurisë, por duke vlerësuar në tërësi rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.
57. Duke u rikthyer te çështja konkrete, subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, dhe personat e lidhur me të rezultojnë të kenë deklaruar pasuri për të cilat gjenden në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për t'i justifikuar këto pasuri, për të cilat subjekti i rivlerësimi nuk ka arritur të provojë me dokumente burimin e tyre, si pasojë edhe ligjshmërinë e të ardhurave, dhe kjo mungesë, në rastin më të mirë sipas pretendimeve të vetë subjektit të rivlerësimit, i afrohet dyfishit të pasurisë së deklaruar, fakt i konstatuar edhe nga Komisioni.
58. Sipas variantit të parë të parashtruar në ankim, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, raporti i pasurisë neto me të ardhurat neto është në vlerën “1,74”, sipas variantit të dytë është

¹⁰¹ Shih pikën 22.15 të vendimit nr. 19, datë 26.07.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

“1,88”, ndërsa sipas variantit të tretë është “2,00”¹⁰². Gjithashtu, sipas variantit të parë të parashtruar në ankim, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, raporti i pasurisë neto me të ardhurat neto është në vlerën “2,00”, ndërsa sipas variantit të dytë është “1,76”¹⁰³. Kolegji vëren se sipas aktit të ekspertimit të paraqitur prej vetë subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, rezultojnë diferenca të mëdha mes asaj që subjekti deklaron dhe asaj që ajo provon si burim të ligjshëm të pasurisë. Sipas variantit me raportin më të ulët të pasurisë neto me të ardhurat neto, prej “1,74”, sërisht subjekti i rivlerësimit rezulton me një diferencë negative për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive me të ardhura të ligjshme prej 13.696.402 lekësh (si diferencë e të ardhurave neto 01.07.1996 - 27.01.2017 me pasuritë e blera dhe të krijuara 01.07.1996 - 27.01.2017).

Gjithashtu, në lidhje me të ardhurat e përfituara në emigracion në Greqi nga subjekti dhe personat e lidhur, në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, datë 18.10.2018¹⁰⁴, deklaron se kanë krijuar të ardhura rreth 330.000 euro e në vlerësim të akteve të sjella nga subjekti, Kolegji vlerëson se rezultojnë diferenca të mëdha me të ardhurat e provuara e dokumentuara të ligjshme. Duke u bazuar në “Dëshminë e sigurimeve dhe kontributeve sipas totalit të ardhura”, subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat nga emigracioni në Greqi arrinin shumën prej 129.439,79 eurosh, që janë më të larta se ato të konsideruara nga Komisioni, por Kolegjit i rezulton që gjithsesi janë me diferencë të madhe në raport me të ardhurat që ka deklaruar se ka krijuar në emigracion (sa më lart). Diferenca thellohet më tej me të ardhurat nga Greqia të konsideruara nga Komisioni, të dokumentuara sipas “Deklaratë e tatimit të të ardhurave nga shërbimi publik i financave {***}, Athinë”, duke konsideruar dhe të ardhurat nga asistenca provuar me dokumentacion, sjellë pranë Kolegjit më datë 08.11.2019, për një total prej 96.743,59 eurosh. Në të gjitha variantet, në çdo rast subjekti i rivlerësimit rezulton me diferenca të mëdha mes asaj që deklaron dhe të ardhurave që ajo ka arritur të provojë.

59. Shprehimisht, sipas Komisionit: “28.1. Me anë të këtij akt ekspertimi, subjekti ka pretenduar të hedhë poshtë rezultatet e analizës financiare të përpiluar nga Komisioni dhe të dërguara me rezultatet e hetimit administrativ, duke nxjerrë përfundimin se raporti i pasurisë neto me të ardhurat neto është në vlerën 1,78, duke evidentuar në fakt se nuk justifikon plotësisht me burime të ligjshme krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve përgjatë kësaj periudhe, por duke pretenduar se ajo dhe personat e lidhur me të nuk kanë deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme”.
60. Nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, se të ardhurat e pambuluara kanë pasur për burim punësimin e pasiguar në emigracion, pasi këto të ardhura nuk përmbushin kriterin e *pagës*, si një e ardhur e ligjshme, e cila ka për burim një kontratë punësimi të lidhur sipas ligjit, dhe për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore, çka bie ndesh me përcaktimet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në mungesë të paraqitjes së dokumenteve që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve, sipas nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë as se këto të ardhura kanë ardhur nga jashtë shtetit në formën e remitancës.

¹⁰² Shih f. 35 - 36 të ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi.

¹⁰³ Shih f. 32 - 33 të parashtrimeve, datë 01.07.2020, të subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi.

¹⁰⁴ Në deklaratën “vetting” nuk shprehet vlerë e të ardhurave të përfituara.

60.1 Të vlerësuara në tërësi këto rrethana, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës.

- 61.** Në përfundim të gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi, Kolegji, pasi shqyrtoi vendimin nr. 106, datë 13.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, pasi ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e saj dhe të personave të lidhur, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se vendimi i Komisionit për sa i përket masës së shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 106, datë 13.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
U shpall sot, në Tiranë, më datë 08.07.2020.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATOR

Luan DACI

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi